

VENDIM
Nr. 684, datë 2.11.2005

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SHQIPTARE TË LIQENIT TË SHKODRËS “REZERVAT
NATYROR I MENAXHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 shkronja “ç”, 13, pika 1, e 23 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonës shqiptare të liqenit të Shkodrës “Rezervat natyror i menaxhuar”, sipas hartës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Rezervati natyror i menaxhuar i liqenit të Shkodrës, kufizohet:

Nga veriu: Me pikën kufitare “Hani i Hotit” (42° 20’ 17” 19° 26’);

Nga perëndimi: Me kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë me Republikën Serbi-Mali i Zi;

Nga lindja: Me rrugën kombëtare automobilistike Shkodër-Hani i Hotit;

Nga jugu: Me vijën që bashkon grykëderdhjen e liqenit të Shkodrës me pikën kufitare (koordinatat: 42° 04’ 18” 19° 23’, 42° 03’ 08” 19° 29’ 30”).

3. Rezervati natyror i menaxhuar i liqenit të Shkodrës ka një sipërfaqe të përgjithshme 26 535 ha, të përbërë nga:

- sipërfaqe ujore	15 719 ha;
- sipërfaqe pyjore e shkurre	1965 ha;
- të tjera	8851 ha.

4. Rezervati natyror i menaxhuar i liqenit të Shkodrës ndahet në zonat, si më poshtë vijojnë:

a) Zonë qendrore (në hartë e shënuar me “1/a”) e përbërë nga:

Bregu i liqenit nga ekstremi perëndimor i fshatit Zogaj deri në kufirin e Republikës së Shqipërisë me Malin e Zi dhe shpati i malit të Taraboshit nga kuota 494 m lartësi, në jug, deri 20 m në brendësi të ujërave të liqenit, në veri, brenda segmentit Zogaj-kufiri shqiptaro-malazez. Në këtë zonë të zbatohet shkalla e dytë e mbrojtjes.

b) Zonë e menaxhimit të habitateve (në hartë e shënuar me “2/a”) e përbërë nga:

e gjithë sipërfaqja ujore e liqenit, me përjashtim të asaj të përfshirë në zonën “1/a”, përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike; bregu perëndimor i pjesës shqiptare nga ura e Bunës, në lindje, deri në fshatin Zogaj, në perëndim (kufiri me zonën “1/a”, të përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike), duke përfshirë të gjithë gjerësinë e këtij segmenti, deri në lartësinë 300 m në faqen e malit të Taraboshit, në jug.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes.

c) Zona e zhvillimit tradicional (në hartë e shënuar “3”) e përbërë nga:

e gjithë sipërfaqja në pjesën lindore të liqenit, e kufizuar, në perëndim, me zonën 2/a, të përmendur në shkronjën “b” të kësaj pike, deri në rrugën automobilistike Shkodër-Hani i Hotit, në lindje, dhe qytetin e Shkodrës, në skajin juglindor.

Në këtë zonë të zbatohet shkalla e katërt e mbrojtjes.

5. Administrata e rezervatit natyror të menaxhuar të liqenit të Shkodrës përbëhet nga dhjetë punonjës (rangers), që janë në përbërje të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Për vitin 2006 këta punonjës do të paguhen nga projekti italian i peshkimit “Programi i mbështetjes së peshkimit artizanal dhe i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Shkodrës: (COD MAE: 6661/COOP/ALB) dhe pas këtij viti, nga Buxheti i Shtetit.

6. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave që, në

bashkëpunim me pushtetin vendor, organizatat jofitimprurëse, përfaqësuesit e komunitetit dhe institucionet shkencore, të hartojë rregulloren e administrimit, planin e menaxhimit dhe programin e monitorimit të rezervatit natyror të menaxhuar të liqenit të Shkodrës.

7. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha